



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 600/6 Prot.

Tiranë, më 16.11.2023

V E N D I M

Nr. 235, Datë 16.11.2023

Mbështetur në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 76, datë 15.05.2023, të A.B e përfaqësuar nga F.L¹ kundër Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar²”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Unë F.L, nëna e A.B po ju drejtohem për diskriminimin që i është bërë vajzës sime. Vajza ime (me Sindromën Down), nxënëse e Gjimnazit me Orientim Gjuhësor “Shejnaze Juka”, Shkodër, ka punuar jo me programin e zakonshëm lëndor, por me Plan Edukimi Individual (PEI) në lëndët: Matematikë, Letërsi, Gjuhë e huaj dhe Psikologji-Qytetari, gjatë viteve shkollore 2019-2022. Në bazë të Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020, neni 84 “Ndjekja e shkollës, vlerësimi i nxënësit me AK”, pika 7, 8, 9 e kësaj rregulloreje përcakton se këto nxënës nuk mund t’i nënshtrohen testit të zakonshëm, por kërkon test specifik sipas përcaktimeve ligjore.

¹ Referuar deklaratës datë 15.05.2023, ankuesja ka deklaruar se pranon të përfaqësohet nga znj. F.L.

Referuar Certifikatës Familjare datë 15.05.2023, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile të Bashkisë Shkodër, znj. F.L është nëna e A.B.

² Referuar Vendimit nr. 360, datë 08.11.2021, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, KMCAP ka vendosur se A.B është person me aftësi të kufizuara, Grupi II, me diagnozën Sindroma Down.

Pavarësisht kërkesës që është bërë nga shkolla dhe nga unë si prind për hartimin e testit të veçantë, nxënëses i është mohuar kjo e drejtë dhe rezultati i mohimit të kësaj të drejte ka sjellë penalizimin e saj me notë jo kaluese në provimet e mëposhtme: Letërsi, Lëndë me zgjedhje (Psikologji-Qytetari), si dhe më pas edhe pse e vlerësuan me notë kaluese në provimet e vjeshtës në mënyrë fiktive, rezultati përfundimtar ishte vlerësimi me notën mesatare 6, e si rezultat nuk iu dha e drejta për të vazhduar studimet në degën e Italianistikës në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, (ku kërkohet mesatarja 6.5) sepse aty ka shfaqur aftësi për të mësuar, në mënyrë që të mos dekurajohet, për të ecur më tej në zhvillimin e saj emocional, intelektual e për gjithëpërfshirjen e saj në shoqëri”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe ti kërkohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, që të angazhohet për ti dhënë mundësi vajzës së saj, që të vazhdojë studimet në degën e Italianistikës në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Shkodrës.

Nëse nuk pranohet kjo kërkesë, përsëri për arsye të përmirësimit të saj emocional dhe intelektual, të krijohen kushtet lehtësuese të vazhdojë studimet në programe auditimi (pa kredite) në fushën e artit (Pedagogji muzikore ose Pikturë e grafikë), pasi janë të vetmet mundësi të provojë të ndjekë studimet, në varësi të aftësive që do të shfaqë. Të tjerat nuk janë të përshtatshme për të, sepse nuk ka aftësitë fizike, psikologjike e intelektuale.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në nenin 7 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi³”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

³ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkëlqet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me shkakun e pretenduar nga ankuesi.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 600/1, datë 30.05.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga MAS, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - Informacion të detajuar mbi procedurën e ndjekur për krijimin e kushteve për zhvillimin e provimeve të maturës shtetërore, për nxënësen A.B.
 - Kopje të kërkesave të bëra nga ankuesja, shkolla, ZVAP Shkodër dhe Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, lidhur me problematikën e nxënëses A.B, dhe përgjigjet e dhëna nga të gjitha institucionet.
 - Informacion mbi mundësitë reale që mund të ketë ankuesja për të ndjekur arsimin e lartë.

Me shkresat nr. 3467/6, datë 15.06.2023 dhe nr. 3467/7, datë 21.06.2023, Ministria e Arsimit dhe Sportit, dërgoi dokumentacionin e kërkuar dhe në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Nxënësjë A.B, në vitet 2019-2022, ka ndjekur arsimin e mesëm të lartë në gjimnazin me orientim gjuhësor “Shejnaze Juka”, Shkodër dhe e ka përfunduar me provimet e Maturës Shtetërore 2022. Gjimnazi me orientim gjuhësor “Shejnaze Juka” Shkodër, me shkresën nr. 65, datë 12.06.2023, ka përcjellë në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) Shkodër, relacion lidhur me arsimimin dhe vlerësimin e kësaj nxënësjë.

Në provimet e Maturës Shtetërore 2022, në sesionin e parë, maturantja A.B është vlerësuar me nota jo kaluese në dy provime, atë të gjuhës shqipe dhe letërsisë dhe në provimin me zgjedhje. Në këto kushte ajo i ka ridhënë këto dy provime në sesionin e dytë të provimeve të Maturës Shtetërore 2022, përkatësisht: provimi i gjuhës shqipe dhe letërsisë është dhënë me datë 30.08.2022 dhe provimi me zgjedhje është dhënë me datë 07.09.2022.

Sipas shkresës së ZVAP Shkodër me nr. 1764/1, datë 08.06.2023, ky institucion ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm në zbatim të Rregullores së Maturës Shtetërore 2022, neni 26, pika 5, për mauranten A.B.

Gjithashtu, ZVAP Shkodër, ka komunikuar me Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA) me email, përkatësisht në datat: 10.06.2022, 27.06.2022 dhe 30.08.2022, duke i përcjellë listat e maurantëve/kandidatëve me aftësi të kufizuar dhe dokumentacionin shoqëruës, përfshirë dhe për mauranten A.B.

Pas përfundimit të sesionit të dytë të provimeve të Maturës Shtetërore 2022 dhe vlerësimit të testeve nga QSHA-ja, maurantja A. B i ka përfunduar me sukses katër provimet e Maturës Shtetërore 2022 duke u vlerësuar me këto nota: Gjuhë shqipe dhe Letërsi 6.5; Matematikë 5.93; Gjuhë Gjermane (B1) 4.5; Lënda me zgjedhje 4.93, si dhe me notë mesatare 6. Në përfundim të arsimit të mesëm të lartë, nxënëses A.B i është lëshuar Diploma e Maturës Shtetërore nga QSHA-ja, si dhe Certifikata e Maturës Shtetërore, nga gjimnazi me orientim gjuhësor “Shejnaze Juka”, Shkodër.

Për sa më sipër, rezulton se për mauranten A.B janë zbatuar dispozitat e Rregullores së Maturës Shtetërore 2022.

Në ligjin nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 74, pika 1, parashikohet: “Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Në Vendimin nr. 436, datë 03.06.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim”, i ndryshuar, pikat 1-3, parashikohet:

- 1. Kanë të drejtë të aplikojnë për t’u pranuar në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2020–2021 dhe në vijim , përkatësisht, si më poshtë:*
 - a) Në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, kandidatët, që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë, minimalisht me notë mesatare 6.5 (gjashtë pikë pesë);*
 - b) Në programet e studimit të gjuhëve të huaja, të përcaktuara në shtojcën nr. 1 të këtij vendimi, minimalisht me notë mesatare 7 (shtatë);*

c) Në programet e studimit të ciklit të parë Bachelor, të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë master në fushën e mësuesisë, të përcaktuara në shtojcën nr. 2, të këtij vendimi, minimalisht me notë mesatare 7.5 (shtatë pikë pesë).

2. Shfuqizuar.

3. Përjashtohen nga detyrimi i plotësimit të kriterit të notës mesatare kandidatët që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare, me karakter profesional, kandidatët që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve në fushën e artit dhe të sportit, si dhe kandidatët me origjinë shqiptare nga Republika e Kosovës, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci”.

Në datën 08.02.2023, znj. F.L i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të MAS me një kërkesë nëpërmjet së cilës ka kërkuar arsimimin e mëtejshëm të vajzës së saj, e cila për shkak se nuk pati mundësi që ti japë provimet e maturës me test të veçantë nuk arriti mesataren e kërkuar 6.5 për të vazhduar studimet e larta. Në përfundim F.L kërkon që vajzës së saj ti jepet mundësia të vazhdojë studimet pranë Departamentit të Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.

Në shkresën nr. 1017/1, datë 03.03.2023, të MAS, me lëndë “Kthim përgjigje kërkesës për arsimim të mëtejshëm”, drejtuar F.L thuhet: “... Për nxënësen A.B nga ZVAP Shkodër, është zbatuar Rregullorja e Maturës Shtetërore 2022, neni 26, pika 5. Lidhur me kërkesën për arsimimin e mëtejshëm të nxënëses ju informojmë se në VKM-në nr. 436, datë 03.06.2020 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim”, i ndryshuar, është përcaktuar se kanë të drejtë të aplikojnë në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, kandidatët, që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë, minimalisht me notë mesatare 6.5. Sipas këtij vendimi përjashtohen nga detyrimi i plotësimit të kriterit të notës mesatare kandidatët që aplikojnë në programet e studimeve dy vjeçare, me karakter profesional, kandidatët që aplikojnë për tu pranuar në programet e studimeve në fushën e artit dhe të sportit si dhe kandidatët me origjinë shqiptare nga Republika e Kosovës, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci.

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, me shkresën nr. 1399/3, datë 08.06.2023, drejtuar Qendrës së Ndihmës Juridike Shkodër dhe për dijeni MAS, ka informuar se: “... A.Q.B rezulton në listat e aplikantëve të sjella nga QSHA, si aplikuese në programin e studimit Bachelor në “Pedagogji Muzikore”, për vitin akademik 2022-2023 Ju informojmë se kandidatja nuk është paraqitur pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit për regjistrimin në konkurs dhe nuk ka marrë pjesë në konkurs për vitin akademik 2022-2023”. Përsa i përket vijimit të studimeve në arsimin e lartë, konkretisht në programet e

studimit të gjuhëve të huaja kërkohet përfundimi i arsimit të mesëm të lartë minimalisht me notën mesatare 7, sipas pikës 1, germa b), të VKM nr. 436/2020 ose me notën mesatare 6.5, sipas përcaktimeve të pikës 3/1, të VKM nr. 436/2020. A.B e cila ka aplikuar në një program studimi në fushën e artit, konkretisht në programin e studimit Bachelor në “Pedagogji muzikore”, pranë Departamentit të Arteve, në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, është përjashtuar nga detyrimi i plotësimit të kriterit të notës mesatare për përfundimin e arsimit të mesëm të lartë, por nuk është regjistruar si dhe nuk ka marrë pjesë në konkurs për vitin akademik 2022-2023”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 600/3, datë 08.08.2023 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 17.08.2023, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca u zhvillua në datë 17.08.2023, me praninë e të dy palëve në proces: subjekti ankues e përfaqësuar nga nëna e saj, znj. F.L dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësueses me autorizim nr. 3467/9, datë 15.08.2023, të MAS, znj. M.R.

Gjatë seancës dëgjimore, palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe që do të shtjellohen në vijim, gjatë arsyetimit të vendimit.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja e ankueses në mes të tjerash deklaroi se: *“Për tre vite të shkollës së mesme (2019-2022) vajza e saj ka ndjekur shkollën dhe ka punuar me plan edukimi individual dhe me mësues ndihmës. Në provimet e maturës shtetërore, vajza ka qenë në klasë të veçantë dhe e shoqëruar me mësues ndihmës, por testi ka qenë si i të gjithë maturantëve të tjerë dhe jo test i veçantë. Menjëherë pas kësaj, në datë 28.06.2022, Drejtori i shkollës dhe mësuesi kujdestar kanë bërë ankesë me shkrim, por nuk kanë marrë përgjigje. Edhe në provimet e sesionit të dytë, vajza nuk ka pasur test të veçantë”.*

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja e MAS-it i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe informoi⁴ se: *“Në Rregulloren e Maturës Shtetërore është parashikuar që nxënësit me AK i sigurohet mjedis i veçantë, shoqërohen me mësues dhe dokumentacioni i tyre futet bashkë me testin që të merret në konsideratë gjatë vlerësimit nga Qendra e Shërbimeve Arsimore. Përsa i përket testeve të*

⁴ Referuar deklariemeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 23.45, e në vijim.

veçanta gjatë MSH 2022 nuk janë aplikuar teste të veçanta, këtë vit (MSH 2023) janë aplikuar për herë të parë. MAS vazhdon që të marrë masa, që të përsoset çdo vit, për sa i përket kësaj pjese, sepse dhe testet e veçanta që u aplikuan këtë vit ishin problematike sepse çdo nxënës ka të veçantat e veta, prandaj është e vështirë të bësh një test të veçantë për të gjithë këto kategori, pastaj ishte dhe pjesa që shumë nuk pranojnë testet e veçanta sepse ndiheshin të diferencuar, prandaj nuk është aplikuar deri këtë vit”.

Në vijim të seancës dëgjimore, MAS me shkresën nr. 3467/10, datë 30.08.2023, informoi Komisionerin si më poshtë: *“Për shkresën me nr. 1266, datë 28.06.2022, të shkollës “Shejnaze Juka” përcjellë pranë ZVAP Shkodër jemi informuar se janë ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për zbatimin e pikës 5, të nenit 26 të Rregullores së Maturës Shtetërore 2022 edhe gjatë sesionit të dytë të provimeve. ZVAP Shkodër ka komunikuar me QSHA-në duke përcjellë listat e maturanëve/kandidateve me aftësi të kufizuar që kanë rezultuar ngelës në sesionin e parë dhe dokumentacionin shoqërues.*

Në lidhje me pajisjen me test të veçantë për personat me aftësi të kufizuara, gjatë provimeve të MSH 2023, QSHA ka marrë masat për hartimin e testeve të veçanta për nxënësit me aftësi të kufizuar. ZVAP-të i kanë përcjellë QSHA-së listën e nxënësve me aftësi të kufizuar, të cilët janë pajisur me një indeks të veçantë për t'u identifikuar. Gjatë MSH 2023 janë hartuar 25 lloje të ndryshme testesh për nxënësit me aftësi të kufizuar për lëndët e detyruara dhe lëndët me zgjedhje. Testet për nxënësit me aftësi të kufizuar, ndryshe nga testet e nxënësve të tjerë, përmbanin vetëm pyetje me alternativa, me një nivel të ulët vështirësie.

Në lidhje me kërkesën e F.L, që vajza e saj të ndjekë studimet pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” theksojmë se mesatarja minimale për t'u pranuar në programet e studimit të gjuhëve të huaja është e përcaktuar shprehimisht me vendim të Këshillit të Ministrave. Ankuesja mund të aplikojë për t'u pranuar në programet e studimit që përjashtohen nga detyrimi i plotësimit të kriterit të notës mesatare”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e

subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e saj për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”.*

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm.

Komisioneri ka shqyrtuar çështjen bazuar në provat dhe informacionin e administruar gjatë procedurës administrative të zhvilluar.

Referuar shkresës nr. 49, datë 15.10.2019 dhe nr. 33, datë 24.09.2021 të Komisionit të Vlerësimit të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të ZVA Shkodër, rezulton se ky Komision ka vlerësuar shkallën e paaftësisë së nxënësës A.B dhe ka vendosur se nxënësja të ndiqet me mësues ndihmës me ngarkesë 20 orë mësimore.

Referuar shkresës nr. 1301, datë 03.10.2022 të Gjymnazit me Orientim Gjuhësor “Shejnaze Juka” Shkodër, vërtetohet se nxënësja A.B ka ndjekur studimet me Planin Edukativ Individual dhe është mbështetur me mësues ndihmës, gjatë viteve shkollore 2019-2022.

Rezulton se pas përfundimit të sesionit të parë të provimeve të Maturës Shtetërore 2022, maturantja A.B ka marrë nota jo kaluese në dy provime, atë të Gjuhës Shqipe dhe Letërsi dhe Provimin me Zgjedhje dhe në dy provimet e tjera është vlerësuar me këto nota: Gjuhë Gjermane (B1) 4.5 dhe Matematikë 5.93. Në sesionin e dytë të provimeve të Maturës Shtetërore 2022, A.B është vlerësuar me këto nota: Gjuhë Shqipe dhe Letërsi 6.5 dhe Provim me Zgjedhje, Qytetari dhe Psikologji 4.93, si dhe në përfundim të shkollës rezulton me notë mesatare të shkollës së mesme 6.53; notë mesatare të MSH 5.47 dhe notë mesatare 6.

Shkolla “Shejnaze Juka” me shkresën nr. 1266, datë 28.06.2022, i është drejtuar ZVAP Shkodër, DRAP Lezhë dhe DPAP Tiranë, në të cilën është ankuar për të drejtën që i është mohuar nxënësës me AK, A.B për të pasur test specifik në provimet e Maturës Shtetërore. Shkresë për të cilën, shkolla dhe nxënësja nuk kanë marrë përgjigje.

Referuar informacionit të dërguar nga palët, rezulton se maturantja A.B, ka zhvilluar provimet në një mjedis të veçantë, e shoqëruar me mësues ndihmës dhe i është nënshtruar testeve standarte të maturës shtetërore të parashikuara si për të gjithë maturantët.

Me shkresën datë 08.02.2023, znj. F.L, nëna e ankueses, duke parë se për shkak të notës mesatare (6) vajza e saj nuk arriti që të ndjekë studimet në arsimin e lartë, i është drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në të cilën i ka kërkuar arsimimin e mëtejshëm të vajzës së saj, në Departamentin e Gjuhëve të Huaja, në Universitetin e Shkodrës.

Ministria e Arsimit dhe Sportit me shkresën nr. 1017/1, datë 03.03.2023, i ka kthyer përgjigje ankueses duke e informuar se: “...VKM-në nr. 436, datë 03.06.2020 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim”, i ndryshuar, është përcaktuar se kanë të drejtë të aplikojnë në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, kandidatët, që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë, minimalisht me notë mesatare 6.5”.

Kuadri ligjor i zbatueshëm.

Me ligjin nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”⁵, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”⁶. Bazuar në nenin 116, të Kushtetutës, ky akt ndërkombëtar i të drejtave të njeriut jo vetëm që bëhet pjesë e të drejtës së brendshme e detyrueshme për t’u zbatuar, por duke patur edhe përparësi ndaj ligjeve të tjera.

KDPAK përfaqëson standardin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Qëllimi i kësaj Konvente është të promovojë, mbrojë dhe sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektin e dinjitetin e tyre të lindur (neni1).

Konventa nuk jep një përkufizim të aftësisë së kufizuar, por pranon se aftësia e kufizuar është një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave/pengesave të qëndrimit/mentalitetit dhe ambientit që pengojnë pjesmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët (Preambula e KDPAK, gërma “e”). Rrjedhimisht në qendër të vëmendjes nuk duhet të jetë paaftësia/paafhtësitë e

⁵ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KDPAK.

⁶ Ratifikuar me ligjin nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me AK”.

mundshme, por kufijtë që ngre shoqëria, duke penguar gëzimin e të drejtave. Nga ana tjetër KDPAK pranon diversitetin e personave me aftësi të kufizuara.

Në nenin 7/1 “Fëmijët me aftësi të kufizuara” të KDPAK është parashikuar se: “1. Shtetet Palë duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që fëmijët me aftësi të kufizuara gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në bazë të barabartë me fëmijët e tjerë”.

Në nenin 24 “Edukimi” të KDPAK është parashikuar se: “1. Shtetet Palë njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për edukim. Me qëllim që të realizohet kjo e drejtë pa diskriminim dhe në bazë të mundësive të barabarta, Shtetet Palë duhet të sigurojnë një sistem edukimi përfshirës në të gjitha nivelet, dhe të mësuara gjatë gjithë jetës, të drejtuar nga:

- (a) Zhvillimi i plotë i potencialit njerëzor dhe sensit të dinjitetit dhe vlerës së vet-vetes, fuqizimit të respektit për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, dhe diversitetit njerëzor;
- (b) Zhvillimi nga personat me aftësi të kufizuara të personalitetit, talenteve dhe kreativitetit të tyre, si dhe aftësive të tyre mendore dhe fizike, në potencialin e tyre të plotë;
- (c) Mundësimin e personave me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në mënyrë efektive në një shoqëri të lirë.

2. Për të realizuar këtë të drejtë, Shtetet Palë duhet të sigurojnë se:

- (d) Personat me aftësi të kufizuara marrin mbështetjen e kërkuar, brenda sistemit të edukimit të përgjithshëm, për të mundësuar arsimimin e tyre efektiv”.

Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” (në vijim ligji 93/2014). Në nenin 3, pika 9, të ligjit të sipërcituar, përcaktohet se: “9. “Persona me aftësi të kufizuara” janë individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët”.

Ligji 93/2014, i ndryshuar, ka për qëllim: “a) të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes;

b) të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për

të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri”.

Në nenin 3, pika 3, të ligjit 93/2014, përcaktohet: “Pengesat” nënkupton: ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika”.

Jetesa e pavarur, u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët. Në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 5, të ligjit 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” parashikohet se: “Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës”.

Sipas shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 5, të ligjit 93/2014, parashikohet: “2. Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës;...”.

Në nenin 49/2 të ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Provimet kombëtare dhe testet ndërkombëtare. 2. Nxënësit me aftësi të kufizuara zhvillojnë provimet kombëtare në përshtatje me veçoritë e tyre”.

Më nenin 84 të Rregullores për funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, të miratuar me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 të MAS, parashikohet se: “... ”.

7. Nxënësit me AK zhvillojnë provimet në përshtatje me veçoritë e tyre.

8. Nxënësit me AK që nuk kanë mësuar me programet e zakonshme lëndore, i nënshtrohen një provimi të posaçëm kombëtar të arsimit bazë dhe të Maturës Shtetërore.

9. Testet e provimeve kombëtare për nxënësit me AK hartohen nga QSHA-ja”.

Në nenin 26/5 të Rregullores së Maturës Shtetërore (2022), të miratuar me Urdhrin e Përbashkët të MAS dhe MFE me nr. 108, datë 04.03.2022, parashikohet se: “Maturantëve/kandidatëve me aftësi të kufizuara, të përkohshme ose të përhershme, me kërkesën e prindit, u krijohen kushte të përshtatshme për zhvillimin e provimit.”.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ZVAP Shkodër me e-mail-in datë 10.06.2022 ka informuar QSHA-në, se: “Nga kërkesat e ardhura nga prindërit dhe bazuar në raportet e komisioneve mjekoligjorë, rezultojnë që kemi 5 maturantë/kandidatë me AK.”.

Bazuar në parashikimet ligjore sa më sipër, analizën e situatës faktike, si dhe në këqyrjen e dokumentacionit provues, rezulton se:

Në përfundim të sesionit të parë të provimeve të Maturës Shtetërore, maturantja A.B nuk i është nënshtruar një testi të përshtatur sipas veçorive të saj, me të cilën kishte zhvilluar procesin

mësimor (PEI) gjatë tre viteve të ndjekjes së shkollës së mesme. Si rezultat i mos hartimit të një testi të veçantë, bazuar në njohuritë e fituara nga maturantja sipas programit të edukimit individual, ankuesja është vlerësuar me nota jo kaluese në provimet e lëndës, Gjuhë Shqipe dhe Letërsi dhe provimin me zgjedhje, Qytetari dhe Psikologji dhe ka marrë nota kaluese në dy lëndët e tjera, por që ky vlerësim nuk përfaqëson njohuritë dhe arritjet reale të nxënësës, pasi ajo kishte zhvilluar procesin mësimor me plan individual, ndërkohë që testi ishte hartuar si për të gjithë maturantët e tjerë të cilët kishin zhvilluar procesin mësimor sipas kurrikulave standarte të MAS.

Duke parë vlerësimin me nota jo kaluese të nxënësës A.B, Shkolla “Shejnaze Juka” me shkresën nr. 1266, datë 28.06.2022, i është drejtuar ZVAP Shkodër, DRAP Lezhë dhe DPAP Tiranë, në të cilën është ankuar për të drejtën që i është mohuar nxënësës me AK, A.B për të pasur test specifik në provimet e Maturës Shtetërore. Shkresë për të cilën, shkolla dhe nxënësja nuk kanë marrë përgjigje.

Pavarësisht ankesës së shkollës dhe të prindit për hartimin e një testi të veçantë dhe gjatë zhvillimit të provimeve të Maturës Shtetërore, të sesionit të dytë, nxënësja A.B i është nënshtuar testeve të hartuara nga QSHA-ja, të njëjtë si për të gjithë maturantët e tjerë.

Nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, rezulton se bazuar në legjislacionin e sipërcituar, nenin 49/2 të ligjit 69/2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, dhe nenin 84/8 të Rregullores për funksionimin e IAP-ve, duhej që MAS dhe institucionet në varësi të saj, të merrnin masa, që nxënësja A.B me aftësi të kufizuara, ti nënshtrohej një testi në përshtatje me veçoritë e saj dhe në përputhje me njohuritë që kishte marrë gjatë procesit mësimor, pasi nxënësja A.B, të gjitha lëndët mësimore gjatë gjithë viteve të shkollimit në shkollën e mesme, i kishte zhvilluar me PEI.

Pavarësisht se maturantja A.B, në përfundim të provimeve të maturës shtetërore, është vlerësuar me nota kaluese në të gjitha lëndët, rezultatet e saj (notat) nuk tregojnë realisht arritjet mësimore të saj, pasi nxënësja gjatë viteve të shkollës ka studiuar me program mësimor të veçantë dhe jo me program mësimor si të gjithë nxënësit e tjerë dhe për këtë arsye dhe rezultatet e saj në provimet e maturës shtetërore, nuk reflektojnë njohuritë dhe arritjet që ajo ka marrë gjatë viteve të shkollës së mesme, pasi mesatarja e shkollës së mesme të ankueses ishte 6.53, ndërkohë që mesatarja e maturës shtetërore pas përfundimit të provimeve ra në 5.47.

Në analizë të legjislacionit të sipërcituar, rezulton se neni 49/2 i ligjit 69/2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, neni 84 i Rregullores për funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, të miratuar me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 të MAS, neni 26/5 i Rregullores së Maturës Shtetërore (2022), të miratuar me Urdhrin e Përbashkët të MAS dhe MFE me nr. 108, datë 04.03.2022 dhe

neni 26/5⁷ i Rregullores së Maturës Shtetërore (2023), të miratuar me Urdhrin e Përbashkët të MAS dhe MFE me nr. 739, datë 15.12.2022, nuk kanë ndryshuar përsa i përket parashikimit për nxënësit me aftësi të kufizuara lidhur me zhvillimin e provimeve të maturës shtetërore, ndërkohë që MAS gjatë zhvillimit të provimeve të maturës shtetërore 2023, në ndryshim me maturën shtetërore 2022, ka marrë masat për hartimin e testeve të veçanta për maturantët me aftësi të kufizuara që nuk kishin mësuar me programet e standarte lëndore.

Pavarësisht faktit që ligji 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Rregullorja e funksionimit të IAP-ve, parashikojnë të drejtën e nxënësve me aftësi të kufizuara që të zhvillojnë provimet kombëtare në përshtatje me veçoritë e tyre, Komisioneri vlerëson se Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk arriti që të japë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për moszbatimin e parashikimeve ligjore të sipërcituara lidhur me hartimin e testeve të veçanta për maturantën me aftësi të kufizuara, që gjatë procesit mësimor kishte punuar/mësuar me plane edukimi individuale.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk ka përmbushur detyrimin ligjor në fuqi, në lidhje me sigurimin e testeve të veçanta për nxënësen A.B gjatë zhvillimit të provimeve të maturës shtetërore 2022. Si rezultat i moszbatimit të këtij detyrimi ligjor nga ana e MAS, ankuesja nuk ka arritur që të vlerësohet me rezultatet (notat) sipas njohurive që kishte përfituar gjatë procesit mësimor, duke i mohuar dhe të drejtën për të ndjekur arsimin e lartë.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se dështimi i MAS-it për të përmbushur detyrimin ligjor për hartimin e testeve të veçanta për maturantën A.B, me qëllim vlerësimin e saj sipas njohurive të përfituara gjatë procesit mësimor, e ka ekspozuar atë ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm.

B. Shkaku i mbrojtur

Mbështetur në nenin 2 , të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1, të LMD, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin

⁷ “Maturantëve/kandidatëve me aftësi të kufizuara, vërtetuar me dokumentin përkatës, me kërkesën e prindit ose të përfaqësuesit ligjor, u krijohen kushte të përshtatshme për zhvillimin e provimit.”

gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Referuar nenit 1, të LMD, shkak i diskriminimit “*aftësia e kufizuar*” i pretenduar nga pala ankuese, konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova të mjaftueshme, që provojnë se ankuesja e mbart këtë shkak.

Referuar Vendimit nr. 360, datë 08.11.2021, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, KMCAP ka vendosur se A.B është person me aftësi të kufizuara, Grupi II, me diagnozën Sindroma Down.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë më pak të favorshëm me shkakun e mbrojtur.

E drejta për arsim, është një e drejtë kushtetuese, e parashikuar në nenin 57 të Kushtetutës, e cila duhet të sigurohet mbi baza të barabarta dhe pa diskriminim. Rëndësia e të drejtës për edukim mbështetet në atë që, ushtrimi i shumë të drejtave të tjera, varet në radhë të parë nga realizimi i të drejtës për arsim, siç theksohet në Komentin e Përgjithshëm Nr. 13 (1999) “*Mbi të drejtën për arsim*”, të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, e drejta për arsim garantohet në kuadër të shumë marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat vendi ynë i ka ratifikuar duke u bërë kështu pjesë e sistemit të brendshëm ligjor jo vetëm të detyrueshme për t’u zbatuar por bazuar në nenin 116 të Kushtetutës në hierarkinë e normave juridike ato renditen menjëherë pas Kushtetutës, të tilla si: Konventa e UNESCO Kundër Diskriminimit në Arsim; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike Social dhe Kulturore, garanton të drejtës për arsim në nenet 13 e 14; Protokollin nr. 1 (neni2) i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut “*E drejta për arsim*”, Konventa e OKB-së “*Mbi të drejtat e fëmijës*” dhe Konventa e OKB-së “*Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara*” (KDPAK).

KDPAK përfaqëson standardin më të lartë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Kjo Konventë në nenin 24 të saj, njeh të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për arsim. Sipas nenit 24, të KDPAK, e drejta për arsim e personave me aftësi të kufizuara realizohet pa diskriminim dhe në bazë të mundësive të barabarta, nëse garantohet një sistem edukimi gjithëpërfshirës.

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar, si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Neni 18, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku sanksionohet ky parim parashikon: “*1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet*

politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive”.

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë.”* (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese)

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, duke mos parashikuar një të drejtë të veçantë në lidhje me aksesueshmërinë, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: *“a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.*

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet⁸. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme⁹. GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14 do të krijojë detyrime pozitive

⁸ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

⁹ Shih: Çështja *Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe domethënëse të ndryshme¹⁰. Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14, nuk e ndalon një shtet anëtar që t'i trajtojë grupet ndryshe për të korrigjuar “pabarazitë faktike” ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të caktuara, dështimi në përpjekje për të korrigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14¹¹.

LMD, është një ligj i cili është miratuar në bazë dhe në zbatim të nenit 18, të Kushtetutës. Në bazë të LMD, jo çdo diferencë në trajtim, konsiderohet diskriminim. Neni 6, i LMD, përcakton: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”*.

Sipas nenit 3, pika 1 të LMD, “diskriminimi” përkufizohet si: *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Në pikën 1, të nenit 5, të LMD, sanksionohet se ndalimi i diskriminimit, sipas formulimit vijues: *“1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.”*

Në nenin 6, të LMD përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”*.

Në Kreun III, të LMD, parashikohet një mbrojtje të posaçme nga diskriminimi në fushën e arsimit. Konkretisht, në nenin 17, pika 1, të LMD parashikohet: *“1. Ndalohet çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji..... ”*

Barra e provës në çështjet e diskriminimit, është objekt i rregullimit të veçantë sipas LMD. Bazuar në nenin 33 pika 7/1, të LMD, sanksionohet se: *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet*

¹⁰Shih: Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

¹¹ Shih: Çështjen *Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë*, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; Çështjen *Thlimmenos*, cituar më lart, prg. 44; Çështjen *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).

se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”. Të njëjtin rregullim, në lidhje me barrën e provës parashikohet edhe nga Kodi i Procedurave Administrative. Konkretisht, në nenin në nenin 82, pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni e ka zhvendosur barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se prima facie është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, pala ankuese duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke provuar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.¹²

Komisioneri çmon të nevojshme të theksoj se, është pikërisht bazuar në standartin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara si dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi, rezultoi e provuar se Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk ka zbatuar legjislacionin në fuqi përsa i përket hartimit të testeve të veçanta për maturanten me aftësi të kufizuara, për më tepër që MAS dhe institucionet në varësi të saj, nuk kanë marrë masa për rregullimin e situatës dhe pas kërkesës/ankesës¹³ së bërë nga shkolla dhe prindi për hartimin e testeve të veçanta për maturanten A.B, gjatë sesionit të dytë të provimeve të maturës shtetërore 2022.

¹² https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

¹³ Referuar shkresës nr. 1266, datë 28.06.2022, të shkollës “Shejnazë Juka”, Shkodër.

Moszbatimi i këtij detyrimi ligjor i miratuar me qëllim sigurimin e një arsimit gjithëpërfshirës për nxënësit me aftësi të kufizuara, ka ekspozuar ankuesen si person me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me maurantët e tjerë.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, ankuesja është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak se moszbatimi i detyrimit ligjor për hartimin e testeve të veçanta për maurantët me AK, e ka vendosur atë përpara një pengese reale, në raport me pjesën tjetër të maurantëve që kanë zhvilluar dhe janë përgatitur gjatë gjithë viteve të shkollimit me programet standarte të mësimin dhe nuk përballen me pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara.

Sa më sipër, rezulton plotësisht e provuar lidhja shkakësore midis shkakut të mbrojtur që në rastin konkret është aftësia e kufizuara dhe trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesja, për shkak të mosrespektimit të detyrimit ligjor të hartimit të testeve të veçanta për maurantët me aftësi të kufizuara, të miratuar nga aktet në fuqi, si më sipër janë cituar.

Komisioneri vlerëson se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, jemi në kushtet kur mund të prezumohet se ka patur diskriminim, pra të diskriminimit *prima facie*. Rrjedhimisht, bazuar në standardin e provës, MAS kishte barrën e provës që të provonte se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesja gjatë provimeve të maturës shtetërore 2022, ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Ministria e Arsimit dhe Sportit në përgjigje të pretendimeve të ankuses, ka parashtruar se ZVAP Shkodër ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm në zbatim të Rregullores së Maturës Shtetërore 2022, neni 26, pika 5, për mauranten A.B.

Lidhur me përgjigjen e dhënë, Komisioneri vlerëson se MAS kishte barrën e provës për të provuar se mos hartimi i testeve të veçanta për maurantët me aftësi të kufizuara gjatë provimeve të maturës shtetërore 2022, ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Komisioneri vlerëson se pavarësisht se në rregulloren e maturës shtetërore 2022 është parashikuar që QSHA është institucioni përgjegjës për përgatitjen e testeve të maturës shtetërore dhe Komisioni i Maturës Shtetërore në ZVAP ka detyrën për organizimin dhe administrimin e provimeve të maturës shtetërore, është Ministria e Arsimit dhe Sportit si institucion përgjegjës i zbatimit të ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH”, i ndryshuar, që në funksion të zbatimit të politikave për arsimin gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të sigurojë zbatimin e legjislacionit për hartimin e testeve të veçanta për maurantët me aftësi të kufizuara. Gjatë provimeve të maturës shtetërore 2022, MAS nuk mori masa për zbatimin e nenit 49/2¹⁴ të ligjit 69/2012, i ndryshuar dhe nenit 84/8¹⁵ të Rregullores për

¹⁴ “Nxënësit me aftësi të kufizuara zhvillojnë provimet kombëtare në përshtatje me veçoritë e tyre”.

funksionimin e IAP-ve, të miratuar me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 të MAS, ndërkohë që pa ndryshuar aktet ligjore dhe nënligjore, gjatë zhvillimit të provimeve të maturës shtetërore 2023, MAS dhe institucionet e varësisë morën masa për hartimin e testeve të veçanta për maturantët me aftësi të kufizuara.

Në parashtrimet e saj, Ministria e Arsimit dhe Sportit, nuk solli asnjë justifikim për të argumentuar, mos hartimin e testeve të veçanta për maturantët me aftësi të kufizuara që zhvilluan provimet gjatë maturës shtetërore 2022.

Nga ana tjetër, Komisioneri argumentoi se MAS dhe institucionet e varësisë nuk kishin zbatuar legjislacionin në fuqi për hartimin e testeve të veçanta për maturantën A.B, gjë e cila ndikoi në rezultatet e kësaj maturanteje duke e penalizuar dhe me mesataren e maturës shtetërore, duke mos u kualifikuar për ndjekjen e studimeve në arsimin e lartë.

E drejta për arsim, është një e drejtë themelore e njeriut, e sanksionuar në nenin 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Shteti ka detyrimin që jo vetëm ta parashikojë, por edhe ta përmbushë këtë të drejtë duke e garantuar atë sipas parashikimeve ligjore të miratuara. Detyrimi për të përmbushur do të thotë që shteti duhet të marrë masa pozitive për të siguruar dhe lehtësuar gëzimin e të drejtave, sidomos për personat me aftësi të kufizuara, të cilët në të kundërt, nuk do të kenë mundësi të kenë qasje në ndjekjen e arsimit si të gjithë nxënësit e tjerë, e për rrjedhojë do të jenë përherë në kushte më pak të pafavorshme në arritjen e rezultateve dhe vazhdimin e studimeve në arsimin e lartë.

KDPAK përfaqëson standardin më të lartë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Kjo Konventë në nenin 24 të saj, njeh të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për arsim. Sipas nenit 24, të KDPAK, e drejta për arsim e personave me aftësi të kufizuara realizohet pa diskriminim dhe në bazë të mundësive të barabarta, nëse garantohet një sistem edukimi gjithëpërfshirës. Në nenin 24/5 të Konventës parashikohet se: “Shtetet palë duhet të sigurojnë se personat me aftësi të kufizuar të jenë në gjendje të kenë mundësi për arsimin e lartë, trajnime profesionale, edukimin për të rritur dhe të mësuarit gjatë të gjithë jetës pa diskriminim dhe në baza të barabarta me të tjerët.”.

Duke mbajtur në konsideratë gjithë sa më sipër, Komisioneri konstaton se, MAS në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për sigurimin e testeve të veçanta për maturantët me aftësi të kufizuara, gjatë provimeve të maturës shtetërore 2022.

GJEDNJ në jurisprudencën e saj, lidhur me diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara, ka mbajtur qëndrimin se: *“duke pasur parasysh nevojën për të parandaluar diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe për të nxitur pjesëmarrjen dhe integrimin e tyre të plotë në*

¹⁵ *“Nxënësit me AK që nuk kanë mësuar me programet e zakonshme lëndore, i nënshtrohen një provimi të posaçëm kombëtar të arsimit bazë dhe të Maturës Shtetërore”*.

shoqëri, marzhi i vlerësimit që gëzojnë shtetet në vendosjen e trajtimit të ndryshëm ligjor për personat me aftësi të kufizuara është ndjeshëm i reduktuar¹⁶ ” dhe “se për shkak të cënueshmërisë së veçantë të personave me aftësi të kufizuara, një trajtim i tillë do të kërkonte arsye shumë të rëndësishme për t’u justifikuar¹⁷.”

Gjithashtu, neni 18, i ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, ngarkon Ministrinë e Arsimit dhe Sportit me përgjegjësi për marrjen e masave me karakter pozitiv për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim. Ndër të tjera Ministria e Arsimit dhe Sportit, është përgjegjëse për të marrë masa me karakter pozitiv me qëllim arsimimin e të gjithë popullsisë, në mënyrë të veçantë, duke marrë masa në favor të grave dhe vajzave, pakicave, personave me aftësi të kufizuara, si dhe personave që janë, ose kanë më shumë mundësi të jenë objekt i diskriminimit, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të ligjit.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se moszbatimi i detyrimit ligjor për hartimin e testeve të veçanta për maturantët me aftësi të kufizuara, e ka vendosur A.B përpara një pengese reale, në raport me pjesën tjetër të maturantëve që kanë zhvilluar dhe janë përgatitur gjatë gjithë viteve të shkollimit me programet standarte të mësimin, gjë e cila ndikoi në rezultatet e kësaj maturanteje duke e penalizuar dhe me mesataren e maturës shtetërore, duke mos u kualifikuar për ndjekjen e studimeve në arsimin e lartë.

Në këto kushte, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesja dhe rrjedhimisht trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i saj, përbën diskriminim sipas parashikimeve të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të LMD, përcaktohet se: “*Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre*”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të lmd, përcaktohet: “*Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës*”. LMD, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit. LMD, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Komisioneri ka konstatuar sjellje diskriminuese ndaj A.B, pasi rezultoi se Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk ka marrë masa për të siguruar hartimin e testeve të veçanta për ankuesen me

¹⁶ Shih: *Glor kundër Zvicrës*, nr.13444/04, prg. 84, GJEDNJ 2009.

¹⁷ Shih: *Guberina kundër Kroacisë*, nr. 23682/13, 73, GJEDNJ 2016.

aftësi të kufizuara, gjatë provimeve të maturës shtetërore 2022 dhe si rrjedhojë e mos sigurimit të këtyre testeve sipas njohurive dhe aftësive të fituara nga A.B gjatë viteve të shkollimit, ankuesja ka qenë në pamundësi objektive që të merrte rezultatet e duhura për ndjekjen e arsimit të lartë. Për rrjedhojë edhe masa rregulluese duhet të jetë në funksion të rregullimit të situatës së diskriminimit të konstatuar dhe sigurimin e vazhdimin të studimeve në arsimin e lartë, sipas mundësisë dhe preferencës së A.B.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, të A.B nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
2. Ministria e Arsimit dhe Sportit, në komunikim me A.B, të marrë masa për të siguruar vazhdimin e arsimit të lartë për ankuesen.
3. Ministria e Arsimit dhe Sportit, të marrë masa për përfshirjen e parashikimit të hartimit të testeve të veçanta për personat me aftësi të kufizuara, në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2024, e në vitet në vazhdim.
4. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Ministria e Arsimit dhe Sportit, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA